

VENDIM
Nr. 75, datë 28.1.2015

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 267, DATË 21.4.2010, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR BASHKËRENDIMIN E
PUNËS SË ALUIZNI-t ME ZYRËN E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME DHE AGJENCINË E KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE,
PËR PROCEDURAT E KALIMIT TË SË DREJTËS SË PRONËSISË MBI TRUALLIN
SHTETËROR NË ZONAT ME PËRPARËSI TURIZMIN”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7, të ligjit nr. 10186, datë 5.11.2009, “Për rregullimin e pronësisë mbi truallin shtetëror në zonat me përparësi turizmin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në fund të pikës 5, të vendimit nr. 267, datë 21.4.2010, të Këshillit të Ministrave, shtohet një paragraf me përmbajtjen, si më poshtë vijon:

“Relacionet shpjeguese, së bashku me planet e rievimit, të depozituara pranë ZRPP-së, rishikohen nga ALUIZNI nëse evidentohen ndryshime në gjendjen faktike të njësive të ndërtuara. ALUIZNI depoziton relacionin dhe planin e rievimit, të rishikuara, për zonën me përparësi turizmin, në ZRPP-në përkatëse, duke zëvendësuar ato pararendëse.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama